

VENDIM
Nr.3, datë 11.1.2011

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
MIDIS OST SHA DHE “CEZ SHPËRNDARJA” SHA

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.68, datë 23.6.2008, pikës 4.13 germa “a” pika 3, pikës 7 germa “g”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.1.2011, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe “Cez Shpërndarja” sh.a.

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte të legjitimuara për nënshkrimin e një marrëveshjeje për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike duke ditur që OST sh.a. është licencuar për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.24, datë 26.3.2009, Cez Shpërndarja sh.a. është licencuar për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.58 datë 3.6.2008.

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338 datë 19.3.2008, Rregullat e Tregut, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.68, datë 23.6.2008, të ndryshuar.

- Modeli i Tregut e vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe “Cez shpërndarje” sh.a., dërguar në ERE me shkresën nr.6755/2 Prot. dhe nr.2538/2 Prot., datë 2.11.2010.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta